REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno/Prejato / Recieved/Delivery 10 . 12 . 2018 vitit god year			
Organ/Njesia / Organ/Jedinica / Org./Unit	Nr.Prot: / Br.Prot: / Prot No:	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
EKPMSHCK	7527 / 2018		1/1

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 335 /2018
Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Shëndetësisë, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Shëndetësisë.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Shëndetësisë, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.

4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:
-Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
-Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
-Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery	10 . 12 . 201 8		vitit god year
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7527 / 2018		1113

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

MINISTRINË E SHËNDETËSISË

PËR VITIN

2017

Prishtinë, 2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje 3

Funksioni i Mbikëqyrjes.....3

Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....3

Fushat e mbikëqyrjes.....4

Raporti për mbikëqyrjen në Ministrinë e Shëndetësisë.....5

Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....7
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....8
Procedurat Disiplinore.....9
Procedurat e Ankesave.....9
Procedurat e Vlerësimit.....10
Procedurat e Pushimeve.....10
Procedurat e Transferimit.....10
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....11
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....12
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....13
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....13
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....13
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....13
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....13
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....13

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar "Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil", mbi bazën e të cilit edhe harton "Planin e Mbikëqyrjes" në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive për realizimin e objektives sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Shëndetësisë për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Ministrinë e Shëndetësisë me datë 11.06.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregulloren (QRK) Nr.07/2015 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Vendimin me Nr. 42/V/2015 të datës 18.05.2015 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Departamentit Ligjor", Vendimin me Nr. 22/I/2017 të datës 17.01.2017 dhe Vendimin me Nr. 187/X/2017 të datës 18.10.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit", Vendimin me Nr. 201/XI/2017 të datës 30.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Planifikim Strategjik Shëndetësor", Vendimin me Nr. 200/X/2017 të datës 30.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Zhvillimit Strategjik Shëndetësor", Vendimit me Nr. 203/XII/2017 të datës 04.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Sistemeve të Informacioneve Shëndetësore", Vendimit me Nr. 217/XII/2017 të datës 20.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar", Vendimit me Nr. 94/III/2017 të datës 20.03.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Farmacisë", Vendimit me Nr. 58/V/2016 të datës 31.05.2016 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Kujdesit Parësor", Vendimit me Nr. 16/17 të datës 23.02.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik", Vendimit me Nr. 174/IX/2017 të datës 07.09,.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore", Vendimit me Nr. 168/VIII/2017 të datës 16.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme" dhe Vendimit me Nr. 64/VI/2016 të datës 10.06.2016 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor"
- Dosjen e procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Depos"
- Marrëveshjet për shërbime të veçanta për vitin 2017 dhe konkurset për këto marrëveshje;
- Listën e Pagave për muajin dhjetor 2017;
- Vendimin me Nr. 46/I/2018 i datës 30.01.2018 dhe Vendimin me Nr. 66/VII/2016 i datës 01.07.2016 për emërimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Listën e ankesave të parashtruar pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Raportin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2017;
- Vendimin me Nr. 70/VII/2016 i datës 12.07.2016 për emërimin e Komisionit Disiplinor dhe rastin e inicimit të procedurës disiplinore;
- Lista e trajnimeve jashtë vendit;
- Vendimin me Nr. 116/III/2018 i datës 29.03.2018 për pezullim parandaliues nga puna me 50% të pagës;
- Vendimin me Nr. 115/III/2018 i datës 29.03.2018 për pezullim parandaliues nga puna me 50% të pagës;

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë" p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040, web: kpmshck.rks-gov.net

- Vendimin me Nr. 117/III/2018 i datës 29.03.2018 për pezullim parandalues nga puna me 50% të pagës;
- Vendimin me Nr. 15/17 i datës 23.02.2017 për pezullim parandalues nga puna me 50% të pagës;
- Vendimin me Nr.73/II/2017 i datës 24.02.2017 për pezullim parandaliues nga puna me 50% të pagës;
- Vendimin me Nr. 13/01/2012 i datës 16.01.2012 për pezullim parandalues nga puna me 50% të pagës;
- Vendimin me Nr. 20/I/2017 i datës 17.01.2017 për pezullim parandalues nga puna me 50% të pagës;
- Vendimin me Nr. 92/III/2014 i datës 17.03.2014 për pezullim parandalues nga puna me 50% të pagës;
- Vendimin me Nr. 21/I/2017 i datës 17.01.2017 për pezullim parandalues nga puna me 50% të pagës;
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën "Inspektor Farmaceutik";
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën "Inspektor Shëndetësor" dhe Vlerësimin e periudhës provuese i datës 08.08.2017;
- Dosjen e nëpunësit civil "Zyrtar për Programin Kundër HIV-AIDS";
- Plani vjetor i rekrutimit;
- Marrëveshjet për transferimin e nëpunësve civil;
- Vendimin me Nr. 149/VI/2017 i datës 19.06.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit;
- Vendimin me Nr. 120/IV/2017 i datës 27.04.2017 për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil dhe Vendimin me Nr. 158/VII/2017 i datës 14.07.2017 për shfuqizimin e vendimit për trasnferimin e përkohshëm të nëpunësit civil;
- Vendimin me Nr. 05-7330 të datës 06.10.2017 për lejimin e pushimit të lehonisë;
- Vendimin me Nr. 124/V/2017 i datës 02.05.2017 për pushim pa pagesë.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë e Shëndetësisë më datë 11.06.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren (QRK) Nr.07/2015 për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Shëndetësisë. Në këtë institucion janë të punësuar 106 nëpunës civil, ndërsa 28 pozita janë të lira.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje atë për pozitën "Zyrtar për Programin Kundër HIV-AIDS", "Inspektor Farmaceutik" dhe "Drejtor i Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik", në bazë të vlerësimit të gjitha dosjet personale ishin të kompletuara në pajtim me dispozitat e nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2017 ka pasur katërmbëdhjetë (14) pozitë me Ushtrues të Detyrës (Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, Udhëheqës i Divizionit për Planifikim Strategjik në Shëndetësi; Udhëheqës i Departamentit të Zhvillimit Strategjik Shëndetësor; Udhëheqës i Departamentit të Informacioneve

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

Shëndetësore; Sekretar i Përgjithshëm; Zyrtar Kryesor Financiar; Udhëheqës i Divizionit të Farmacisë; Udhëheqës i Divizionit të kujdesit Parësor; Udhëheqës i Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik; Udhëheqës i Divizionit të burimeve njerëzore; Udhëheqës i Departamentit të Financave dhe Shërbime të Përgjithshme; Udhëheqsh i Departamentit të Informimit Shëndetësor; Udhëheqës i Departamentit Ligjor). Kolegji gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 76/16 të datës 28.06.2016 dhe Vendimit me Nr. 116/17 të datës 09.11.2017 për caktimin Ushtruesit të Detyrës për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë", konstaton se kjo pozitë me ushtrues detyre ka qenë për një periudhë më të gjatë se tre muaj.

Me këtë veprim Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohorë të caktimit të ushtruesit të detyres.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Ministrin e Shëndetësisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që në rastet e caktimit të ushtruesit të detyres për pozitat e nivelit të kartë drejtues të respektohen të gjitha afatet ligjore lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës në pajtim me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 16 paragrafit 4 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 42/V/2015 të datës 18.05.2015 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Departamentit Ligjor", Vendimit me Nr. 22/I/2017 të datës 17.01.2017 dhe Vendimit me Nr. 187/X/2017 të datës 18.10.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit", Vendimit me Nr. 201/XI/2017 të datës 30.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Planifikim Strategjik Shëndetësor", Vendimit me Nr. 200/X/2017 të datës 30.11.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Zhvillimit Strategjik Shëndetësor", Vendimit me Nr. 203/XII/2017 të datës 04.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Sistemeve të Informacioneve Shëndetësore", Vendimit me Nr. 217/XII/2017 të datës 20.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar", Vendimit me Nr. 94/III/2017 të datës 20.03.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Farmacisë", Vendimit me Nr. 58/V/2016 të datës 31.05.2016 për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Kujdesit Parësor", Vendimit me Nr. 16/17 të datës 23.02.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik", Vendimit me Nr. 174/IX/2017 të datës 07.09,.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore", Vendimit me Nr. 168/VIII/2017 të datës 16.08.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme" dhe Vendimit me Nr. 64/VI/2016 të datës 10.06.2016 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor", ka konstatuar që këto pozita më ushtrues detyre kanë qenë për një periudhë më të gjatë se tre muaj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

Me këtë veprim Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohor për caktimin e ushtruesit të detyrës.

REKOMANDIMI 2:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, që të respektohen të gjitha afatet ligjore lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2017, ka zhvilluar njëzetë (20) procedura të rekrutimit prej këtyre procedurave tri (3) janë anuluar qoftë me ankesë qoftë për shkak të mos përmbushjes ligjore. Po ashtu në këtë institucion janë lidhur nëntëmbëdhjetë (19) kontratë me marrëveshje për shërbime të veçanta të cilat janë zhvilluar në bazë të konkursit publik dhe ka pasur tejkalim të afateve ndërsa shumica janë lidhur për pozita të shërbimit civil. Pas analizimit të procedurave të regrutimit (Zyrtar i Depos) dhe marrëveshjeve për shërbime të veçanta kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të procedurës së rekrutimit për pazotën "Zyrtar i Depos", kemi konstatuar që testi me shkrim pjesa e tretë (pjesa e njohurive që lidhen me vendin e punës) ka përmbajt gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) pyetje ku nëntë (9) prej tyre kanë qenë me përgjigje të shumëfishta ndërsa dy (2) prej tyre në formë eseje, që është në kundërshtim me nenin 36 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil pasi që në këtë pjesë kandidatëve u parashtrohen pesëmbëdhjetë (15) deri në njëzetë e tri (23) pyetje ku 50% duhet të jenë me përgjigje të shumëfishta dhe 50% me përgjigje në formë eseje.

REKOMANDIMI 1:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Menaxherin e Personelit dhe Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil, që testi me shkrim të përgatitet konform nenit 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë për vitin 2017 ka pasur të angazhuar nëntëmbëdhjetë (19) të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta për të cilat ka zhvilluar procedura të thjeshtësuara të rekrutimit, në dy raste kemi konstatuar që ka pasur tejkalim të afatit të kontratave më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

Me këtë veprim Minsitria e Shëndetësisë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për sa i përket afatit kohor të angazhimit të këtyre kontratave.

REKOMANDIMI 2:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë që të eliminoj shkeljet pasi që kontratat me shërbime të veçanta nuk mund të angazhohen me shumë se gjatë muaj siç përcaktohet me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/l-149 për Shërbimin Civil të Republikës së

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

Kosovës.

E GJETURA 3: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se disa prej tyre kanë qenë të angazhuar në pozitën e nëpunësve civil.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarëve: ***„pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës".***

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 3:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, që me rastin e lidhjes së Kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të njëjtat nuk mund të lidhen për pozita të shërbimit sepse me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës janë vetë dy kategri të të punësuarve.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë në bazë të Vendimit me Nr. 70/VII/2016 të datës 12.07.2016 ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të vlerësimeve në këtë institucion është inicuar një procedurë disiplinore por nuk është shqiptuar asnjë masë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë në bazë të Vendimit me Nr. 66/VII/2016 të datës 01.07.2016 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar, ndërsa më datë 30.01.2018 është nxjerr Vendimi me Nr. 46/I/2018 për emërim të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i përbërë nga dy (2) anëtar të përhershëm dhe një sipas rastit. Në bazë të vlerësimeve në këtë komisioni gjatë vitit 2017 janë parashtruar tetë (8) ankesa dhe të cilat ky komision përveç një ankesë të gjitha i ka shqyrtuar. Lidhur me emërimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe shqyrtimin e ankesave, kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 46/I/2018 të datës 30.01.2018 për emërimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, ka konstatuar që ky komision është i emëruar me dy anëtar të përhershëm ndërsa në pikën e dytë është përcaktuar që anëtari i tretë caktohet sipas rastit, mbi këtë bazë kemi konstatuar që në bazë të nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar që kryesuesi dhe anëtarët e

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

komisionit emërohen për një mandat dy (2) vjeçar, rrjedhimisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave duhet ti ketë të tre (3) anëtarët me mandat 2 vjeçar.

REKOMANDIMI 1:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë që të eliminoj shkeljen që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave duhet të emëroret me tre anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar siç është përcaktuar me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve, kemi konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka shqyrtuar ankesën me Nr. prot: 05-6178, rrjedhimisht është konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka qenë i obliguar të bëjë shqyrtimin e çdo ankese e cila parashtrohet nga nëpunësit civil apo kandidatët për pranim në shërbimin civil, pasi që është obligim sipas nenit 9 paragrafit 7 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

REKOMANDIMI 2:
Rekomandojmë Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në bazë të dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit Nr.-03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave është i obliguar të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave që parashtrohen në këtë komision, në këtë kuptim edhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë duhet të ketë mbikëqyrje ndaj këtij komisioni.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë, nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil pasi që për 13 nëpunës civil nuk është bërë vlerësimit i rezultateve në punë, ndërsa në bazë të shqyrtimit të dosjeve vlerësimet tjera janë bërë brenda afateve ligjore. Në vitin 2017 ndaj një nëpunësi civil është dashur ti kryer vlerësimi i periudhës provuese. Lidhur me procedurën e vlerësimit kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në dosjet personale ka konstatuar se për 13 nëpunës civil të Ministrisë së Shëndetësisë nuk është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2017 edhe pse Zyra e Personelit ka përcjell e-mailin tek udhëheqësit e drejtpërdrejtë të nëpunësve që vlerësimit duhet të bëhet në fund të dhjetorit të vitit 2017, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është shkelje e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat nenit 3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë, sepse moskryerja e vlerësimit mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës për masë disiplinore sipas nenit 33 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjohem të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëheqësit e drejtpërdrej të nëpunësve civil që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet për të gjithë nëpunësit pasi q është obligim ligjor ashtu siç parashihet me nenin 33 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil t Republikës së Kosovës dhe nenit 3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve n Punës të Nëpunësve Civilë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në dosjet personale respektivisht dosjes së nëpunësit për pozitën "Inspektor Shëndetësor", ka konstatuar që të njëjtit i është kryer vlerësimi i periudhës provuese por kemi konstatuar se kjo pozitë është rekrutuar në vitin 2016 dhe kandidatit të përzgjedhur Akt Emërimi ju është lëshuar më datë 03.08.2016, ndërsa formulari për vlerësimin e punës provuese i është lëshuar më datë 08.08.2017 me çka nënkuptohet se vlerësimi i periudhës provues nëpunësit nuk i është bërë 40 ditë para përfundimit të periudhës provuese ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 2:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, që të ndërmerr masat që n të ardhmen për të gjitha vlerësimet e periudhës provuese të bëhen në pajtim me afatet dhe hapat e përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, në bazë të vlerësimit ë dosjeve këto pushime i kanë dëshmuar me raporte mjekësore, tre (3) nëpunës civil ka realizuar pushimin pa pagesë dhe në dosje ka pasur kërkesën dhe vendimin po ashtu tre (3) nëpunëse civile kanë realizuar pushimin e lehonisë dhe në këtë kuptim për të gjitha pushimet mjekësore, vjetore, pa pagesë dhe lehonisë janë respektuar dispozitat e Rregullores Nr. 06/2010 për Pushimet e Neptunëve Civil..

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2017 ka pasur vetëm shtatë (7) transferime prej tyre persë (50 të jashtme dhe dy (2) të brendshme, ndërsa në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që transferimet janë bërë në pajtim me Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimet e Nëpunësve Civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë ka të punësuar 106 nëpunës civil prej tyre 104 janë shqiptar dhe 2 turq, prej 106 nëpunësve civil të punësuar 49 janë të punësuara femra ndërsa 57 janë meshkuj ndërsa në këtë ministri ka vetëm një (1) nëpunës civil të punësuar nga personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me përfaqësimin e personave me nevoja të veçanta kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 106 nëpunësve civil të punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë vetëm dy (2) janë të punësuar nga komunitetet që jetojnë në Kosovës, me çka nuk është plotësuar kuota e përqindjes

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net**

10% e përfaqësimit etnik në institucione e përcaktuar me nenin 11 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 11 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 106 nëpunësve civil të punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, vetëm një prej tyre është i punësuar nëpunës civil nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar në shkërbim civil një duhet me qenë person me nevoja të veçanta.

REKOMANDIMI 2:
Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Shëndetësisë, asnjë nëpunës civil nuk ka shfrytëzuar të drejtës e pezullimit të dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil. Në bazë të vlerësimit të dosjeve tre (3) nëpunës civil kanë realizuar pushim pa pagesë, ndërsa një (1) nëpunës civil i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dorëheqje, nuk ka asnjë nëpunës civil të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me shkarkim, një nëpunësi civil i është përfunduar marrëdhënia e punës me pensionim ndërsa nuk ka asnjë nëpunësi civil ë i është përfunduar marrëdhënia e punës për arsye shëndetësore, apo dënim nga gjykata.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Shëndetësisë nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban pozitë të shërbimit civil dhe ndonjë post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Shëndetësisë nëntë (9) nëpunës civil janë duke zhvilluar procedurë penale por nuk asnjë nëpunës që është dënuar më vendim të formës së prerë të gjykatës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë respektivisht zyra e personelit, ka përgatitur planin e trajnimeve në të cilin përfshihen edhe trajnimet, por dhe të cilat trajnime janë marrë parasysh nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike ku nëpunësit civil kanë ndjekur trajnimet, ndërsa 21 nëpunës kanë ndjekur trajnimet jashtë vendit në shtetet e ndryshme ku ju kanë paguar shpenzimet.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHTESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë, ka pranuar nëntë (9) vendime të Këshillit për të cilat nuk ka pasur obligim të zbatimit, ndërsa Ministria e Shëndetësisë në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016 dhe janë dhënë nëntë (9) rekomandime prej tyre tri janë adresuar ndërsa të tjerat nuk janë adresuar.

15.SHËNIMET/KOMENTET PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikqyrjes, ka konstatuar njëmbëdhjetë (11) të gjetura dhe ka dhënë njëmbëdhjetë (11) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Ministrisë së Shëndetësisë, që ***gjetjet me rekomandimet*** e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

I dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK

Gjylinaze Gola

Kryetare e Kolegjit

Avdyl Bekteshi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, adresa: "Sheshi Nëna Terezë"
p.n. 10000 Prishtinë, nr tel: +381 38 212 040,
web: kpmshck.rks-gov.net